

Dhuna dhe ngacmimet në botën e punës nuk mund të tolerohen për asnjë arsye, as për garën partiake. Dhuna në botën e punës dhe ngacmimet në të njëjtën botë nuk janë një fenomen i veçuar, nuk janë një fenomen që i takon vetëm një vendi, përkundrazi, janë një fenomen i përhapur gjerësisht në çdo vend të botës. Më 21 qershor të vitit 2019, pra pak para pandemisë, Organizata Ndërkombëtare e Punës, e njohur ndryshe si ILO, miratoi konventën 190 “Për dhunën dhe ngacmimin”, për të cilën jemi duke diskutuar sot, sigurisht, duke mos u mjaftuar vetëm me votën pro, por duke u përpjekur të ngrejë dhe një linjë të vërtetë veprimi për promovimin e saj, për të drejtën që ka çdo punëmarrës për të punuar dhe për t’u trajtuar me dinjitet. Në fakt, është ratifikim marrëveshjeje, sepse, përndryshe, personalisht do të kisha pasur një amendament në Komisionin e Ligjeve për shkrimin e titullit, që krijon një lloj konfondimi, sepse duke vendosur vitin 1986, që është viti i themelimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, krijohet ideja sikur kjo është një konventë që i takon vitit 1986, por konventa është vetëm e vitit 2019 dhe shtete shumë më të zhvilluara se ne, shumë më të zhvilluara edhe se i takon demokracisë, në verën e vitit të kaluar kanë bërë fushata të tëra për promovimin dhe njohjen e kësaj konvente.

Dhuna dhe ngacmimet në botën e punës ngelen të përhapura dhe prekin të gjitha vendet, të gjitha profesionet dhe të gjitha mënyrat e punës. Këto dukuri shfaqen në forma dhe në kontekste të ndryshme. Pabarazitë në pozitën shoqërore, ndryshimet demografike, ndryshimet në organizimet e punës dhe teknologjisë, natyrisht që krijojnë mundësitë që ky fenomen të përkeqësohet, por kjo do të zvogëlohej në rast se, veçanërisht duke marrë spunto nga sot, kujdesemi që të punësuarit ose punëmarrësit të vetëdijesohen për të drejtat e tyre, që këto të drejta t’i promovojmë në mënyrë të vazhdueshme dhe, nga ana tjetër, në rast se kujdesemi maksimalisht për fuqizimin e viktimave të kësaj dhune, më së pari, duke u solidarizuar dhe duke shfaqur empati për to.

Jo shumë kohë më parë bota dhe veçanërisht rrjetet sociale u përfshinë në një lëvizje të gjerë shoqërore, të identifikuar me hashtag-un #metoo (edhe unë), i cili, nëpërmjet dëshmimeve personale, synoi të nxirrte në pah dhunën dhe ngacmimin seksual, kryesisht atë në vendin e punës apo të lidhur me vendin e punës. Kjo lëvizje filloi nga personalitete të shquara botërore të artit, kinematografisë dhe sportit... Kryetare, a mund ta ndërpres, sepse kam një problem me zërin? Faleminderit! Ndjesë!